



NDRYSHIM I THIRRJES PUBLIKE NR. 03/2015 PËR DORËZIMIN E KËRKESËS PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE NGA PROGRAMI PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2015

**MASA 131 SHOQËRIM EKONOMIK TË EKONOMIVE BUJQËSORE PËR KRYERJE TË PËRBASHKËT TË VEPRIMTARISË BUJQËSORE**

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) informon të gjitha subjektet e interesuara për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në zhvillimin rural për vitin 2015 për masën 131 Shoqërim ekonomik të ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore se për shkak të përpilimit të ndryshimeve dhe plotësim të Ligjit për kooperativa bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 23/2013 dhe 51/2015) në pjesën e shqyrtimit të mundësisë për realizim të së drejtës së përkrahjes financiare për furnizim të mekanizmit bujqësor si dhe pjesën për zgjerim të masave për përkrahje financiare për aplikimin e mënyrës së unifikuar të prodhimtarisë bujqësore nga ana e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave bëhet ndryshim i Thirrjes Publike 03/2015.

Në pjesën I LËNDË E SHPALLJES në tabelë fshihen:

**Numri rendor 5 “masa 131.3 Ndhimë për premitë për sigurim në lloj të kompensimit në pjesën e shpenzimeve për sigurim edhe atë në shumë e cila nuk do të kalojë 70% të shpenzimit për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore të kapacitetit të vogël dhe 80% për sigurim të kapaciteteve prodhuese për kooperativë bujqësore të kapacitetit të madh, por jo më shumë se 3.000.000, denarë në nivel vjetor”**

**Numri rendor 6 “Masa 131.4 Investime për furnizim të mekanizmit bujqësor në shumë prej 90% nga vlera e përgjithshme e furnizimit”**

Pjesët e tjera të Thirrjes Publike 03/2015 të publikuar më datë 18.04.2015 mbeten të pandryshuara dhe përmbajtja e saj e tërësishme mund të gjendet në ueb faqen e Agjencisë:

[www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).